



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË
MINISTARSTVO ZA TRGOVINU I INDUSTRIJU
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY

PROFILI I SEKTORIT TË **TURIZMIT**







PROFILI I SEKTORIT TË TURIZMIT

Mirënjohjet dhe Falenderimet

Ky raport është financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Finlandës brenda kornizës së angazhimeve përmes projektit “Ndihmë Tregtisë”, implementuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).



Për realizimin e këtij raporti kontribut i veçant është dhënë nga:

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë:

Kabineti i Ministrit
Departamenti i Industrisë
Departamenti i Integriteteve Evropiane dhe Koordinimit të Politikave
Agjencia për Mbështetje të Investimeve dhe Ndërmarrjeve në Kosovë

Anketimi në terren realizuar nga TNS Index Kosova, Agjenci për hulumtime sociale, të mediave dhe marketingut

Kontrolli i Cilësisë:

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) Kosovë
Njësia për Politika, Hulumtime, Çështje gjinore dhe komunikim
Njësia për Zhvillim Gjithpërfshirës
Projekti “Ndihmë Tregtisë”
Petrit Gashi, Phd – Konsulent i Jashtëm

Autor

Hajrulla Çeku

Përkthyes në gjuhën Shqipe:

Hyjnor Jasiqi

Dizajni: “XHAD Studio”, Prishtinë

Shtypi: “Grafika Reznici” Prishtinë

Si dhe një falenderim i veçantë për të gjithë respondentët e përfshirë në hulumtim.

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të pjesëmarrësve dhe të autorëve, dhe në asnjë mënyrë nuk përfaqësojnë qëndrimet zyrtare të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Finlandës.

E drejta autoriale © 2014. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Përmbajtja

Mirënjohjet dhe Falenderimet	2
Përmbajtja	3
Lista e shkurtesave	5
1. Hyrje	6
2. Të dhënat themelore të kompanive.....	8
Rubrika 1: Profili i një biznesi të suksesshëm që vepron në Kosovë	10
3. Kontributi dhe prodhimi nga kompania/industria.....	11
4. Performanca e kompanive	12
5. Rregulloret tregtare dhe tregtia e lirë.....	15
6. Punësimi dhe kapacitetet njerëzore në kompani/industri	16
6.1 Rregullimi i punës në Kosovë.....	17
7. Asetet, teknologjia dhe investimet	17
7.1 Patentat, markat tregtare dhe dizajni industrial	18
8. Institucionet publike dhe mjedisi i biznesit	18
9. Legjislacioni dhe zbatimi i ligjit	19
10. Shoqatat afariste të turizmit.....	19
11. Masat stimuluese dhe lista e licencave dhe lejeve të nevojshme	20
11.1 Perceptimet e bizneseve për qeverisje.....	21
11.2 Qasja strategjike	21
12. Kultura dhe turizmi: potencial në rritje	22
12.1 Festalet dhe ngjarjet kulturore	22
13. Mungesa e mbështetjes institucionale	24
14. Asistenca ndërkombëtare për zhvillim të turizmit.....	24
15. Konkluzat dhe rekomandime.....	26
Referencat	28

Lista e shkurtesave

PAT	Preferencat Autonome Tregtare
CEFTA	Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore
BE	Bashkimi Evropian
EUR	Euro
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
GSP	Sistemi i Përgjithësuar i Preferencave
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
SHATK	Shoqata e Turizmit Alternativ në Kosovë
KOTAS	Shoqata e Turizmit në Kosovë
KPEP	Projekti për Ndërmarrjet Private të Kosovës
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
PRO IN	Shoqata e Turizmit PRO IN
ZHER	Zhvillimi Ekonomik Rajonal
AZHR	Agjencia e Zhvillimit Rajonal
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar

1. Hyrje

Objektivi i përgjithshëm i këtij raporti është që t'i ofrojë qeverisë së Kosovës një profil të sektorit të turizmit për të mbështetur strukturimin e intervenimeve specifike për zhvillimin e turizmit në Kosovë. Ky dokument paraqet të dhëna dhe informata të hollësishme, ndonëse jo përfundimtare, për këtë sektor. Raporti është hartuar me ndihmën e të dhënave të përziera makro dhe në nivel të kompanive të grumbulluara përmes burimeve të ndryshme parësore dhe dytësore të të dhënave.

Burimet e të dhënave përfshijnë një anketë të gjerë me kompani të turizmit, shqyrtimin e kornizës ekzistuese legjislative dhe politikat që rregullojnë këtë sektor, raportet ekzistuese dhe të dhënat statistikore për turizëm dhe intervista gjysmë të strukturuar me aktorët relevantë të sektorit (zyrtarë të pushtetit qendror dhe lokal, shoqata të turizmit, organizues të ngjarjeve kulturore, ekspertë të turizmit, etj.). Nga 66 biznese që kanë marrë pjesë në anketë, 45 (68%) janë biznese individuale.

Për qëllime të këtij hulumtimi, mostra e përzgjedhur e hoteleve, restoranteve dhe kafeneve është e kufizuar në komunat me potencial më të madh të zhvillimit të turizmit, gjegjësisht Prizren, Pejë, Gjakovë, Prishtinë, Shtërpçë dhe Dragash.¹ Për sa i përket ngjarjeve kulturore, muzeve dhe objekteve të tjera kulturore, mostra e përzgjedhur përfshinte edhe disa komuna të tjera (Vushtrri, Graçanicë, Mitrovicë dhe Ferizaj).

Në veçanti, profili i turizmit ofron informatat për ndryshimet dhe zhvillimet e politikave dhe ato institucionale në industri dhe kompani. Ky raport plotëson të dhënat dhe statistikën ekzistuese për ta paraqitur jo vetëm gjendjen aktuale por edhe trendet në industrinë e turizmit përgjatë kohës (performance e kompanive, kontributet/prodhimet, shpërndarja rajonale, numri i vizitorëve, etj.).

Kosova nuk ka qasje të drejtpërdrejtë në det dhe kryesisht ka terren kodrinor dhe malor; megjithatë, ajo ka një klimë të favorshme dhe resurse të shumta natyrore, kulturore dhe historike, të cilat përbëjnë një bazë të burimeve për turizëm. Pothuajse të gjitha nismat aktuale për turizëm realizohen nga individë privatë dhe investimet që bëhen nga banorët për t'i rritur të ardhurat e tyre, si dhe për të kontribuar në zhvillimin e turizmit.²

Sipas publikimit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, "Investo në Kosovë" që identifikon disa nga sektorët me potencialin më të lartë për investitorë, Kosova do të bëhet treg i rëndësishëm për investimet e huaja direkte në turizëm.³

1 Kriteret e përzgjedhjes janë bazuar në: numrin e operatorëve turistik, numri i ngjarjeve turistike dhe kulturore, pasuria dhe potenciali natyror, infrastruktura dhe qasja, politikat lokale të zhvillimit të turizmit dhe korniza institucionale.

2 Valdete Rexhepi, Turizmi dhe Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçari: Rasti studimor i Kosovës, 2012, në www.ua.pt/event%5C-invtur2010/ReadObject.aspx?obj=23885

3 Republika e Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Investo në Kosovë, 2011, në http://www.eciks.org/english/publications/InvestinginKosovo_2011_Web.pdf

Kosova është e ndarë në pesë rajone turistike: (1) Rajoni qendror i Prishtinës; (2) Rajoni turistik i Alpeve Shqiptare (Bjeshkët e Nemuna); (3) Rajoni turistik i Sharrit; (4) Rajoni turistik i Anamoravës; dhe (5) Rajoni turistik i Mitrovicës. Të gjithë rajonet e Kosovës kanë vlerë turistike, por ato ndryshojnë sipas nivelit të resurseve për zhvillim.

Sipas të dhënave të Administratës Tatimore të Kosovës për vitin 2012, numri më i madh i bizneseve në industrinë e turizmit bazohet në rajonin e Prishtinës (36.6%), vijuar nga Prizreni (17.2%), Peja (10.1%), Gjlani (9.3%) e kështu me radhë. Nga 66 biznese që kanë marrë pjesë në anketë, 45 prej tyre (68%) janë biznese individuale, 10 (15%) ndërmarrje publike, vijuar nga kategoritë e tjera. Kostoja mesatare mujore e furnizimeve për bizneset e anketuara për vitin 2012 ishte €32,732 (kostoja maksimale) dhe €21,214 (kostoja minimale).

Për sa i përket vlerave të tyre totale të prodhimeve, shumica e bizneseve të anketuara kanë raportuar se kjo shumë nuk tejkalon €100,000 në vit (85% për vitin 2011 dhe 83.37% për 2012). Rezultatet e anketës tregojnë që shumica e bizneseve i kanë deklaruar të hyrat e tyre mesatare vjetore për 2011 dhe 2012 në dy kategori kryesore, €10,001-€50,000 dhe €50,001-€250,000, ndërsa 2.63% dhe 2.56% kanë deklaruar të hyra vjetore prej mbi €1 milionë për 2011 dhe 2012, përkatësisht.


Zhvillimi i barazisë gjinore është çështje thelbësore për ta ndihmuar tërë sektorin në rritjen e fitimeve të tij. Gratë kanë përfaqësim të ulët në sektorin e turizmit, në veçanti në pozita menaxhuese të bizneseve. Vetëm 9.1% e atyre që kanë marrë pjesë në anketë kanë deklaruar se gratë janë pjesë e strukturës së pronësisë së bizneseve.

Në veçanti, turizmi kulturor përbën një nga potencialet e mëdha për zhvillim në Kosovë, por ai shfrytëzohet dhe promovohet shumë pak. Një numër ngjarjesh kulturore organizohen në qytete të ndryshme të Kosovës. Këto aktivitete kryesisht organizohen nga organizata të shoqërisë civile dhe operatorët kulturorë dhe tërheqin turistë vendorë e të huaj. Një nga ngjarjet e përvitshme më me ndikim në Kosovë është festivali i filmit dokumentar, Dokufest, në Prizren. Sipas statistikave të festivalit, rreth 10,000 vetë kanë marrë pjesë në edicionin e vitit 2013 të festivalit, ku 23% nga gjithsej numri i mysafirëve ishin vizitorë të huaj. Hulumtimi i kryer nga Instituti GAP gjatë edicionit të dhjetë të këtij festivali (2011) tregon që ndikimi ekonomik i Dokufestit në BPV-në ishte €3.1 milionë, gjersa ky numër pritet të jetë €21.9 milionë gjatë periudhës së ardhshme katërvjeçare.

2. Të dhënat themelore të kompanive

Numri i bizneseve të regjistruara në industri në vitin 2012 ishte 2,089: 1,938 mikro, 141 të vogla, 9 të mesme dhe 1 kompani e madhe (Figura 1).

Figura 1: Shpërndarja e bizneseve sipas madhësisë⁴




Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës, 2013

Veprimtaritë në vijim konsiderohen si pjesë e industrisë: hotele dhe motele me restorante, hotele dhe motele pa restorante, hostele për të rinj dhe pushim malor, vendet për kamping duke përfshirë vendet për karvanë, objektet për qëndrim të shkurtër, restorante, bare, kantina dhe kuzhina, dhe agjenci turistike.⁵

Numri më i madh i bizneseve në industrinë e turizmit janë me seli në rajonin e Prishtinës (36.6%), vijuar nga Prizreni (17.2%) dhe Peja (10.1%) (Figura 2).⁶

Figura 2: Shpërndarja e bizneseve sipas rajoneve



Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës, 2013


⁴ Administrata Tatimore e Kosovës, 2012. Kodet vijuese të ATK-së janë shfrytëzuar për t'i nxjerrë shifrat përkatëse: 5511, 5512, 5530, 5540, 6010, 6021, 6023, 6210, 6220, 6330

⁵ Megjithatë, bazuar në natyrën e tyre, veprimtaritë e mëposhtme janë përdorur për të krijuar statistika të sektorit nga të dhënat e ATK-së: hotele dhe motele me restorant, hotele dhe motele pa restorante, restorante, bare, transportit hekurudhor, transport tjetër i planifikuar tokësor i udhëtarëve, transportit tjetër tokësor i udhëtarëve, transport i planifikuar ajror, transport i paplanifikuar ajror, si dhe agjencitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë/të asistencës turistike

⁶ Po aty

Nga 66 bizneset që kanë marrë pjesë në anketë, 45 nga to (68%) janë biznese individuale, 10 (15%) ndërmarrje publike, vijuar nga kategoritë e tjera (Figura 3). Rreth 97% të pronarëve të bizneseve që kanë marrë pjesë në anketë janë shqiptarë të Kosovës. Nga pronarët që kanë marrë pjesë në anketë, 43.8% janë të moshës 22 deri 41 vjeçe, dhe 56.3% të moshës 42 deri 65 vjeçe. Personat që kanë marrë pjesë në anketë kanë deklaruar se vetëm 9.1% të grave janë pjesë e strukturës së pronësisë së biznesit të tyre.


Figura 3: Shpërndarja e bizneseve sipas strukturës së pronësisë



Burimi: Anketa e UNDP-së, 2013

Arsye për shqetësim është niveli i ulët i pjesëmarrjes së grave në sektor. Personat që kanë marrë pjesë në anketë kanë deklaruar se vetëm 9.1% të grave janë pjesë e strukturës së pronësisë së biznesit të tyre.

Figura 4: A është ndonjëri nga pronarët e kompanisë/organizatës/institucionit grua?



Burimi: Anketa e UNDP-së, 2013

Rubrika 1: Profili i një biznesi të suksesshëm që vepron në Kosovë⁷

Çarshia e Jupave (hotel & restorant)

Çarshia e Jupave gjendet në Gjakovë dhe ofron shërbime të akomodimit (hotel) dhe ka një restorant. Konsiderohet si një ndër kompanitë më të suksesshme në rajon. Kompania ka një traditë të gjatë familjare. Ajo vepron që mbi 60 vite, filluar së pari nga babai i pronarit aktual të kompanisë. Pronari aktual është aksionari i vetëm i kompanisë, ku anëtarët e ngushtë të familjes gjithashtu janë të angazhuar në menaxhimin e kompanisë. Shërbimet tjera që ofrohen janë një sallë për konferenca, ndërsa dy shërbime të reja që janë në fazën përgatitore janë një dhomë e verërave dhe një hapësirë për rekreacion (fitnes dhe të tjera).

Kompania ofron çmime mjaft konkurruese, ku qëndrimi për një natë ndryshon nga 40 deri 80 euro. Shuma e përafërt e shpenzimeve mujore të kompanisë është €6,000, ndërsa qarkullimi vjetor është mbi €340,000. Gjatë dy viteve të fundit, kompania ka pasur rritje mesatare të qarkullimit prej tetë deri dhjetë për qind në vit. Për vitin vijues parashikohet një rritje prej 10%. Hoteli është një nga destinacionet më atraktive i zgjedhjes së turistëve të huaj. Përveç kësaj, aty organizohen shumë ngjarje të shoqërisë civile, afariste dhe qeveritare ku salla e konferencës, akomodimi dhe ushqimi ofrohen në pako. Suksesi i kompanisë buron kryesisht nga tradita e gjatë familjare kombinuar me shërbimet cilësore që ofrohen në çmime konkurruese dhe të arsyeshme. Restoranti i hotelit shërben jo vetëm turistë por edhe klientë lokalë nga Gjakova.

Kompania ka 30 punonjës, nga të cilët 13 janë gra dhe 17 burra. Shumica absolute e punonjësve janë shqiptarë të Kosovës, ndërsa vetëm 1 është nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian. Përveç këtyre, kompania gjithashtu angazhon punonjës sezonalë dhe me gjysmë orari, varësisht nga nevojat dhe sezoni. Nga radhët e atyre që aktualisht janë të punësuar, 80% janë me shkollim të mesëm, 10% shkollim universitar, ndërsa 10% të tjerë vetëm shkollim fillor.


Pronari flet për marrëdhënie të mira me bizneset lokale (kryesisht nga Gjakova) që janë furnitorët kryesorë të kompanisë. Për sa i përket fushave që do të duhej të përmirësoheshin për t'i shtuar mundësitë për biznes, pronari thekson furnizimin me energji elektrike, që është shërbim publik i domosdoshëm për funksionim normal të një hoteli apo restoranti. Për sa i përket politikës legislative, pronari ngul këmbë në nevojën për rikthimin e licencimit dhe kategorizimit për hotele, që më parë janë menduar të jenë pengesa dhe janë larguar për të nxitur zhvillimin e hoteleve. Së fundi, por jo për nga rëndësia, ai ngul këmbë për nevojën e rishikimit të TVSH-së të aplikuar për hotele, për t'i pasqyruar praktikën e shteteve të tjera të Ballkanit.

7 Profili i kompanisë është realizuar bazuar në të dhënat kualitative nga intervista e realizuar më 26 Nëntor, 2013 me Shkëlqim Jupa, pronar i Çarshia e Jupave.

3. Kontributi dhe prodhimi⁸ nga kompania/industria


Kostoja mesatare mujore e furnizimeve për bizneset e anketuara ishte €21,214 (kosto minimale) dhe €32,732 (kosto maksimale) më 2012. Për sa i përket kostove të shërbimeve komunale në vit, 85% të bizneseve kanë deklaruar se kanë paguar deri në €1,000 në vit për energji elektrike (Figura 5), 94% kanë paguar €500 dhe €800 për ujë (Figura 6) dhe rreth 80% prej tyre kanë paguar deri në €1,000 për derivate.

Figura 5: Kostoja mesatare për energji elektrike për 2012



Burimi: Anketa e UNDP-së, 2013

Figura 6: Kostoja mesatare për ujë për 2012




Burimi: Anketa e UNDP-së, 2013

8 Në anglisht: Input and output

Për sa i përket vlerës së tyre totale të prodhimeve, shumica e bizneseve të anketuara kanë raportuar se kjo shumë nuk tejkalon €100,000 në vit (85% për 2011 dhe 83.37% për 2012). Vetëm 3% të bizneseve kanë raportuar vlerë të prodhimeve më të lartë se €5 milionë (Figura 7).

Figura 7: Prodhimi vjetor për 2011 dhe 2012 (në Euro)




Burimi: Anketa e UNDP-së, 2013⁹

9 Llogaritjet/përqindjet përfshijnë vetëm bizneset që janë përgjigjur në këtë pyetje.

4. Performanca e kompanive

Rezultatet e anketës tregojnë se shumica e bizneseve i kanë deklaruar të hyrat e tyre mesatare vjetore për 2011 dhe 2012 në dy kategori kryesore, €10,001–€50,000 dhe €50,001–€250,000, ndërsa 2.63% dhe 2.56% kanë deklaruar të hyra vjetore prej mbi €1 milionë për 2011 dhe 2012, përkatësisht (Figura 8).

Figura 8: Të hyrat mesatare vjetore për 2011 dhe 2012 (në euro)



Burimi: Anketa e UNDP-së, 2013

Sektori i akomodimit dhe shërbimit të ushqimit ka prodhuar qarkullim vjetor prej €34 milionë më 2007, që përbënte 2.28% të BPV-së.¹⁰ Megjithatë, të dhënat zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) tregojnë se kontributi i hoteleve dhe restoranteve në BPV ndryshonte nga 0.7 – 1.4% gjatë viteve 2006 – 2011.¹¹ Kjo është dëshmi e mungesës së të dhënave të besueshme për turizmin dhe pjesëmarrjen e tij në ekonominë e Kosovës. Shumica e të hyrave nga turizmi vlerësohen të jenë nga sektori privat (90 - 95%), gjersa pjesa tjetër nga sektori publik (5 - 10 %).¹²

Të dhënat zyrtare nga ASK paraqesin numrin e vizitorëve vendorë dhe të huaj dhe qëndrimet e tyre me fjetje për periudhën 2008-2012. Më 2012, numri i vizitorëve është rritur për 18.86% krahasuar me 2011, gjersa numri i qëndrimeve me fjetje gjatë të njëjtës periudhë është rritur për 16.20% (Figura 9). Rritje është realizuar edhe në numrin e vizitorëve të huaj (60.76%), si dhe në qëndrimet e tyre me fjetje (38.7%).¹³


10 Strategjia për promovimin e investimeve e Agjencisë për Promovimin e Investimeve në Kosovë 2011-2013 http://www.invest-ks.org/repository/docs/02_Investment_Promotion_Strategy_656355.pdf

11 Republika e Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Bruto Prodhimi Vendor sipas veprimtarive ekonomike (2006 – 2011), 2012, në http://esk.rks-gov.net/eng/publikimet/doc_download/1059-gross-domestic-product-by-activities-2006-2011

12 Strategjia për promovimin e investimeve e Agjencisë për Promovimin e Investimeve në Kosovë 2011-2013, në http://www.invest-ks.org/repository/docs/02_Investment_Promotion_Strategy_656355.pdf

13 Republika e Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat të hotelerisë, 2013, në http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/81-hoteleria


Figura 9: Numri i vizitorëve (vendorë dhe të huaj) dhe qëndrimet e tyre me fjetje për vitet 2008 – 2012



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2013


Sipas statistikave të ASK-së për hotelerinë, vizitorët e huaj që kanë qëndruar më së gjati në Kosovë vijnë nga shtetet në vijim: Shqipëri, Kroaci, Gjermani, Britani e Madhe, Itali, Slloveni, Turqi dhe SHBA (Figura 10).¹⁴

Figura 10: Numri i vizitorëve të huaj sipas shteteve të prejardhjes për 2008 – 2012 (8 shtetet e para)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2013

Figura 11: Qëndrimet me fjetje të vizitorëve të huaj sipas shtetit të prejardhjes për 2008 – 2012
(8 shtetet e para)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2013

Sipas të dhënave të Shoqatës së Turizmit Alternativ në Kosovë (SHATK), Kosova ka realizuar rritje prej 20% në numrin e turistëve të huaj në gjashtë muajt e parë të vitit 2013, krahasuar me të njëjtën periudhë kohore më 2012.¹⁵

Kosova, në mes të ndryshimeve substanciale, është në një fazë zhvillimore ku turizmi po konsiderohet si aset thelbësor. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) ka vendosur një synim që turizmi do të përbëjë 10-12% të BPV deri më 2020. Gjersa ky objektiv ambicioz është inkurajues, ai gjithashtu ngrit një numër pyetjesh, përfshirë edhe atë nëse Kosova i posedon resurset e nevojshme, infrastrukturën dhe kapacitetin për ta përmbushur këtë synim, për të mos përmendur vizionin afatgjatë dhe strategjinë e shëndoshë dhe të qëndrueshme.¹⁶

¹⁵ Intervistë me Baki Hotin, Udhëheqës i Shoqatës së Turizmit Alternativ në Kosovë, kryer më 19 nëntor 2013.

¹⁶ Këshilli i Evropës, Dilemë: përdorimi i trashëgimisë kulturore për turizëm apo shfrytëzimi i turizmit për mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e trashëgimisë kulturore? <http://www.coe.int/t/dg4/cultureheritage/cooperation/kosovo/PejaHeritageArticle.pdf>

5. Rregulloret tregtare dhe tregtia e lirë

Kosova karakterizohet si territor me regjim liberal tregtar, me një tarifë të përgjithshme prej 10% për importe dhe 0% për eksporte.

Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore (CEFTA) është marrëveshje tregtare ndërmjet shteteve që nuk janë anëtare të BE-së në Evropën Juglindore. Marrëveshja dikur përfshinte Bullgarinë, Kroacinë, Republikën Çeke, Hungarinë, Poloninë, Rumaninë, Sllovakinë dhe Slloveninë, por anëtarësia e tyre përfundoi pas anëtarësimit të tyre në BE. Aktualisht marrëveshja përfshin Shqipërinë, Bosnje dhe Hercegovinën, Maqedoninë, Moldavinë, Malin e Zi, Serbinë dhe Kosovën.¹⁷

Kosova ka regjim tregtar joreciprok, pa detyrime doganore me tregun e BE-së bazuar në Regjimin e Preferencave Autonome Tregtare të BE-së, në pajtim me Rezolutën e Këshillit të BE-së (PAT)(2007/2000).¹⁸ Përveç kësaj, Kosova gëzon privilegje të Sistemit të Përgjithësuar të Preferencave (GSP) nga qeveria e SHBA-së, duke i dhënë qasje pa detyrime doganore në tregun e SHBA-së (me kufizime për një numër të kufizuar të mallrave).

Në vijim janë procedurat e eksportit sipas MTI-së: Bizneset/Personat e përfshirë në eksport duhet të kenë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me ligjet dhe udhëzimet administrative në vijim: Kodi Doganor dhe i Akcizave në Kosovë, Ligji për tregtinë ndërkombëtare, dhe Udhëzimi Administrativ nr. 01/2011. Gjatë procedurave të eksportit, që nga viti 2011 e tutje, janë të nevojshme dokumentet vijuese: (1) Deklarate Unike e Doganës (DUD), (2) Fatura, dhe (3) Certifikata e origjinës (apo Certifikata EUR 1).

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka nënshkruar marrëveshje për zhvillim të turizmit me Shqipërinë (2006), Maqedoninë (2013) dhe është në proces të nënshkrimit të marrëveshjes me Malin e Zi. Përveç marrëveshjeve për turizëm, Kosova dhe Maqedonia kanë themeluar një komision të përbashkët për bashkëpunim ekonomik ndërkufitar, ku turizmi gëzon vëmendje të posaçme.¹⁹

¹⁷ Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore, në <http://www.cefta.int/>

¹⁸ Agjencia për Promovimin e Investimeve në Kosovë, në <http://www.invest-ks.org/en/General-Publications>


¹⁹ Intervistë me zyrtar të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë kryer më 25 nëntor 2013.

6. Punësimi dhe kapacitetet njerëzore në kompani/industri²⁰

Gjithsej numri i burrave të punësuar në bizneset e anketuara ishte 929 nga 2011 (mesatarisht 15 për biznes), ndërsa numri i grave të punësuar ishte 302 (mesatarisht 7 për biznes). Këta numra kanë pësuar rënie të ulët më 2012, ku bizneset kanë raportuar gjithsej 912 burra dhe 274 gra të punësuar. Pothuajse 24% të bizneseve kanë punësuar staf të përkatësisë joshqiptare në vitin 2012.

Rreth 22% të kompanive të anketuara kanë raportuar shpenzime mesatare mujore për paga prej €80-€800; 35% ndërmjet €1,500-€3,000, 31% ndërmjet €3,200-€9,400 dhe 12% ndërmjet €12,000 dhe €43,000 (Figura 12).


Figura 12: Shpenzimet mesatare mujore për paga më 2012



Burimi: Anketa e UNDP-së, 2013

Shumica e punonjësve në sektorin e turizmit kanë të kryer shkollimin e mesëm, ndërsa 27% të bizneseve kanë raportuar se kanë punësuar 5 ose më shumë burra me shkollim universitar dhe 26% që kanë punësuar 5 ose më shumë gra me diploma universitare. Nga bizneset e anketuara, 22% ofrojnë trajnime në vend të punës për punonjësit e tyre (Figura 13).

Figura 13: Trajnimet në vend të punës të ofruar për punonjësit



Burimi: Anketa e UNDP-së, 20

²⁰ ATK gjithashtu raporton përqindjen mesatare të punonjësve për kompani. Megjithatë, këto të dhëna janë konsideruar si jo të besueshme për shkak të mosdeklarimit të punonjësve, prandaj, në këtë raport janë përfshirë vetëm të dhënat nga anketa

Për sa i përket vështirësive që kanë të bëjnë me burimet njerëzore në sektorin e turizmit, bizneset kanë theksuar çështjet në vijim: mungesa e punonjësve të kualifikuar dhe të shkathët (mbi 50% mendojnë se ky është problem), kostoja e lartë e punonjësve të kualifikuar dhe të shkathët (gati 50% mendojnë që ky është problem), mungesa e të diplomuarve nga shkollat e mesme profesionale të përshtatshëm për sektorin (53%), kosto e lartë e të diplomuarve nga shkollat e mesme profesionale të përshtatshëm për sektorin (50%), mungesa e të diplomuarve universitarë të përshtatshëm për sektorin (55%) dhe kosto e lartë e të diplomuarve universitarë të përshtatshëm për sektorin (pothuajse 50%).


6.1. Rregullimi i punës në Kosovë

Kosova ka një treg fleksibil të punës me normë të ulët tatimore dhe kufizime të pakta në punësimin e punonjësve. Sistemi i normës së tatimit në të ardhura personale është sistem progresiv tatimor me normë prej 0-10 %. Përveç kësaj, vetëm një kontribut pensional prej 5% nga paga e plotë paguhet nga punëdhënësi (gjersa 5% të tjera nga paga e punonjësit). Që nga viti 2011, Kosova ka aplikuar një pagë minimale prej €170, apo €130 për individët nën moshën 35 vjeçe. Që nga viti 2011, marrëdhëniet e punës janë të rregulluara me ligjin e punës (nr. 03/L-212) i cili merr parasysh Konventat e ONP, legjislacionin e BE-së dhe parimet themelore të tregut të lirë dhe ekonomisë së lirë. Që nga viti 2013, shëndeti dhe siguria në punë rregullohen me ligjin për shëndetin dhe sigurinë në punë (nr. 04/L-161).

7. Asetet, teknologjia dhe investimet

Rreth 63% të bizneseve të anketuara kanë në pronësi objektet, gjersa të tjerat veprojnë në objekte me qira (Figura 14). Vlera mesatare e objekteve në pronësi nga këto biznese është rreth €1 milion. Më shumë se gjysma e bizneseve (53.6%) kanë raportuar se kanë në pronësi tokë, gjersa vlera mesatare e tokës në pronësi të tyre është pak mbi €360,000. Mbi 90% të bizneseve janë në posedim të makinerisë dhe pajisjeve (teknologji) dhe vlera mesatare e tyre është rreth €315,000.

Figura 14: Përqindja e kompanive që kanë në pronësi apo marrin me qira objekte



Burimi: Anketa e UNDP-së, 2013

Një e treta e respondentëve të anketës kanë pohuar se kanë investuar në produkte apo shërbime të reja gjatë vitit 2012, gjersa vlera mesatare e investimeve ishte mbi €76,000. Përveç kësaj, një e pesta e bizneseve kanë raportuar se kanë bërë ndryshime inovative përmes shfrytëzimit të pajisjeve të reja teknike dhe softuerëve, gjersa 15% të bizneseve i kanë listuar marketingun, zhvillimin e produkteve dhe promovimin e produkteve si praktika të reja inovative.

7.1. Patentat, markat tregtare dhe dizajni industrial

Të drejtat e pronësisë industriale regjistrohen dhe administrohen nga Agjencia për Pronësi Industriale që vepron në kuadër të Ministrisë për Tregti dhe Industri.

Markat tregtare: janë të rregulluara me ligjin për markat tregtare (nr. 04/L-026). Pronari i markës së regjistruar tregtare, pas regjistrimit, do të ketë të drejta ekskluzive lidhur me mallrat apo/dhe shërbimet e mbuluara nga regjistrimi. Mbajtësi i markës tregtare ka të drejtë të parandalojë palët e treta të përdorin markën pa lejen e tij. Në veçanti, këto të drejta përfshijnë: shfrytëzimin e markës tregtare, autorizimin e një personi tjetër për shfrytëzimin e markës tregtare ose për të shfrytëzuar mjete juridike për shkelje të markës tregtare. Marka tregtare është e regjistruar për një periudhë prej 10 viteve dhe mund të rinovohet për një kohë të pakufizuar.



Dizajni industrial: rregullohet me Ligjin mbi Dizajnin Industrial (Ligji Nr.04/L-028) dhe dizajni është i mbrojtur me ligj deri në masën që është një risi dhe ka një karakter të veçantë. Mbrojtja e dizajnit industrial zgjatë pesë vite dhe mund të zgjatet maksimalisht për 25 vite.

Patentat: rregullohen me Ligjin mbi Patentat (Ligji Nr. 04/L-029). Një shpikje do të jetë e patentueshme nëse ajo është e re, përfshin një hap inventiv, dhe është e zbatueshme në industri. E drejta e patentës jepet për kohëzgjatje prej 20 viteve.

8. Institucionet publike dhe mjedisi i biznesit

Divizioni i Turizmit në MTI është përgjegjës për sektorin e turizmit në Kosovë. Detyrat, përgjegjësitë, organizimi dhe veprimtaria e këtij divizioni rregullohen me anë të një akti nënligjor për organizimin dhe strukturën e brendshme të Ministrisë. Ligji për turizmin parasheh themelimin e Këshillit të Turizmit në Kosovë. Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit janë që të propozojë politika dhe plane për zhvillim të turizmit dhe promovim të tij, të këshillojë dhe japë rekomandime për Ministrinë, si dhe t'i hartojë standardet dhe Kodin e Etikës për subjektet e regjistruara. Këshilli do të përbëhet nga një (1) përfaqësues nga Ministria, tre (3) përfaqësues nga Qeveria, dhe tre (3) përfaqësues nga shoqatat e turizmit, komunat dhe ekspertë të pavarur.²¹ Sipas kryesuesit të Divizionit të Turizmit "Këshilli është në fazën fillestare për t'u bërë funksional, ku anëtarët e tij tashmë janë emëruar dhe rregullorja e punës është në proces të miratimit".²²

Gjatë viteve të fundit janë bërë përpjekje për avancimin e kornizës institucionale për turizmin edhe në nivel të pushtetit lokal. Disa komuna kanë përfshirë turizmin në planet e tyre strategjike të zhvillimit, ndërsa në aspektin organizativ, kanë krijuar pozita të turizmit në kuadër të drejtorive të caktuara komunale, kryesisht ato që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik. Kohëve të fundit, komuna e Prizrenit madje ka themeluar një njësi të re të quajtur Turizmi dhe Zhvillimi Ekonomik.²³

²¹ Gazeta Zyrtare e Kosovës, Ligji për turizmin, 10 maj 2013, në http://mti-ks.org/repository/docs/LAW_No_04-L-176_ON_TOURISM_Anglisht_772395.pdf

²² Intervistë zyrtar të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë mbajtur më 25 nëntor 2013

²³ Komuna e Prizrenit, Drejtoritë, <http://kk.rks-gov.net/prizren/Municipality/Drejtoret.aspx>

9. Legjislacioni dhe zbatimi i ligjit

Akti kryesor ligjor që rregullon industrinë është Ligji për Turizmin (Ligji Nr. 04/L-176) që ka hyrë në fuqi më 10 maj 2013. Ligji i ri bën përpjekje që të liberalizojë industrinë, dhe aplikon logjikën e tregut të lirë dhe përcakton dispozita vullnetare për bizneset (licenca dhe kategorizim). Ky ligj rregullon marrëdhëniet ndërmjet institucioneve publike dhe subjekteve private, personave fizikë dhe juridikë dhe qytetarëve dhe të huajve që ushtrojnë veprimtari turistike. Ai përcakton të drejtat dhe detyrimet e subjekteve që marrin pjesë në fushën e turizmit, në pajtim me standardet e përcaktuara në legjislacion. Meqë ky ligj zëvendëson ligjin e vjetër dhe aplikon një koncept të ri të zhvillimit të turizmit, qeveria është duke punuar në zbatimin e dispozitave të thelbësore të tij.

Disa ligje të tjera rregullojnë industrinë e turizmit në fusha të caktuara të veprimtimit, në veçanti në fushat ku turizmi është çështje ndërsektoriale, gjegjësisht: mbrojtja e konsumatorëve, taksat e akomodimit, trashëgimia kulturore, infrastruktura, mbrojtja e natyrës, produktet bujqësore, etj. Ligji për taksën e akomodimit në objekte hoteliere e turistike përcakton që personat që shfrytëzojnë shërbimet e akomodimit në hotele dhe objekte turistike duhet të paguajnë taksë për këtë shërbim, duke shtuar se kjo taksë llogaritet si përqindje (%) e çmimit të shërbimit të fjetjes (që gjithashtu rregullohet me një akt nënligjor të lëshuar nga MTI).²⁴

²⁴ Gazeta Zyrtare e Kosovës, Ligji për Taksën e akomodimit në objekte hoteliere e turistike, 07.01.2009, në http://www.gazeta-zyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=318&Itemid=28&lang=en

10. Shoqatat afariste të turizmit

Në Kosovë ekzistojnë dhe veprojnë disa shoqata të turizmit. Shoqata e Turizmit të Kosovës (KOTAS) është shoqatë jofitimprurëse, joqeveritare, e themeluar nga individë me qëllim që të mbështesin zhvillimin e turizmit me interes të përbashkët dhe sektorët, programet dhe nismat e saj të lidhura të zbatuara në të gjitha nivelet në Kosovë. Drejt qëllimit të saj për ta mbështetur zhvillimin e industrisë së turizmit në Kosovë dhe përm-bushur qëllimet e parapara të saj, KOTAS bashkëpunon dhe bashkërendon aktivitetet e saj me shoqatat dhe organizatat e tjera turistike, si në Kosovë ashtu dhe jashtë vendit.²⁵

Shoqata e Turizmit Alternativ në Kosovë (SHATK) është shoqatë jofitimprurëse e turizmit e krijuar kohëve të fundit, që ka për qëllim të kontribuojë në zhvillimin e sektorit të turizmit në Kosovë. SHATK është e angazhuar fuqishëm në përm-bushjen e objektivave kryesore të saj për zhvillimin e turizmit rural, kulturor dhe malor; bashkërendimin e aktiviteteve ndërmjet operatorëve turistikë, agjencive të udhëtimit dhe hoteleve; ruajtjen e trashëgimisë kulturore; luftimin e cenueshmërisë së investimeve të huaja në sektorin e turizmit; dhe organizimin e aktiviteteve të ndryshme duke përfshirë panairë të turizmit, konferenca të turizmit dhe trajnime.²⁶

Aktualisht, SHATK është i përbërë nga 146 anëtarë – kryesisht hotele, agjenci turistike, operatorë turistikë, kompani transporti, ekspertë individualë të turizmit dhe institucione të tjera – dhe bashkërendon Këshillin e Hoteleve të Kosovës.²⁷

Shoqata e Turizmit e rajonit jugor është një nismë e përbashkët ndërmjet Agjencisë për Zhvillim Rajonal në Jug dhe Komunës së Prizrenit. Kjo shoqatë ofron shërbime për subjektet turistike duke organizuar një forum për këmbim dhe avokim për trajtimin e sfidave me të cilat përballen bizneset. Në të njëjtën kohë, shoqata ofron shërbime për ngritjen e kapaciteteve që kanë për synim zhvillimin e bizneseve lokale duke forcuar kapacitetet e tyre profesionale dhe integruar turizmin në agjendat e zhvillimit ekonomik lokal. Vëmendje e veçantë i është dhënë shkëmbimit të përvojave me homologët në rajon në fushën e gastronomisë, hotelerisë, udhërrëfyesve, verërave dhe të ngjashme. Përveç kësaj, shoqata siguron mjete për zhvillimin e turizmit rural duke angazhuar komunitetin në ofrimin e shërbimeve për vizitorët.²⁸

Shoqata PRO IN është themeluar më 2012 dhe synimi i saj është promovimi i ushqimeve dhe pijeve vendore. Ajo është aktive në patentimin e këtyre produkteve, si dhe në ngritjen e kapaciteteve të stafit të hoteleve dhe restoranteve. Ajo ka 2,500 anëtarë individualë dhe 120 biznese nga të gjitha pjesët e Kosovës. Shoqata po bën përpjekje të krijojë një bashkëpunim të strukturuar me qeverinë lokale e qendrore të Kosovës, parakusht i domosdoshëm ky për trajtimin e sfidave me të cilat përballen bizneset përkatëse.²⁹

²⁵ Shoqata e Turizmit në Kosovë (KOTAS), <http://www.balkanalliance.org/kotas.php>

²⁶ Shoqata e Turizmit Alternativ në Kosovë (KATA), <http://www.kata-ks.org/About%20Us.html>

²⁷ Intervistë me Baki Hoti, Udhëheqës i Shoqatës së Turizmit Alternativ në Kosovë, 19 nëntor 2013.

²⁸ Intervistë me Bajram Basha, Udhëheqës i Shoqatës së Turizmit, rajoni jugor, 27 nëntor 2013.

²⁹ Intervistë me Afrim Fushtica dhe Xhevdet Hyseni, Udhëheqës të shoqatës PRO IN, intervistuar më 21 nëntor 2013

11. Masat stimuluese dhe lista e licencave dhe lejeve të nevojshme

Ligji i cekur për turizmin synonte që të ofrojë masa stimuluese për personat e angazhuar në industrinë e turizmit, duke hequr kërkesat për licenca dhe leje të caktuara. Neni 6 i Ligjit përcakton se të gjithë personat fizikë dhe juridikë që veprojnë në fushën e turizmit mund të regjistrohen vullnetarisht në Divizionin e Turizmit në MTI.³⁰ Përveç kësaj, Ligji përcakton që Ministria, në bashkëpunim me Këshillin e Turizmit të Kosovës, zhvillon një sistem vullnetar të kategorizimit të akomodimit, bazuar në standardet sipas një sistemi ndërkombëtar të vlerësimit që është në dispozicion për të regjistruarit.³¹

Licencat dhe ky kategorizim më parë kanë qenë të detyrueshme për bizneset turistike (kryesisht për akomodim), ndërsa ligji i ri e bënë këtë vullnetare. Disa biznese vënë në pikëpyetje standardet e reja dhe madje konsiderojnë rikthimin e dispozitave të kaluara për licensim dhe kategorizim kërkesa të obligueshme. Megjithatë, ndonëse

ideja ishte që të stimulohen bizneset që operojnë në sektorin e turizmit, shumë biznese kanë kërkuar të rifuten dispozitat e mëparshme dhe që këto kërkesa të jenë përsëri të detyrueshme.³² Kjo kërkesë është rezultat i praktikës së kategorizimit individualë të hoteleve, që sipas informatorëve kyçë pengon konkurrencën e ndershme në këtë sektor.

Mbi gjysma e bizneseve e shohin ATK-në si mesatarisht efikase

11.1. Perceptimet e bizneseve për qeverisje

Vetëm 15% të bizneseve mendojnë se taksat në këtë sektor janë 'shumë të larta', ndërsa mbi 80% të tyre mendojnë se ato janë 'mesatare' apo 'paksa' të larta. Përveç kësaj, gjysma e bizneseve mendojnë se Administrata Tatimore e Kosovës është 'mesatarisht efikase', ndërsa 62% e tyre e shohin Doganën e Kosovës si 'mesatarisht' efikase apo 'paksa' efikase. Për më tepër, gjysma e bizneseve të anketuara mendojnë se sigurimi i financimit në sektorin e turizmit është 'paksa' i vështirë, gjersa 35% e tyre mendojnë se kostot e financimit (niveli i normës së kamatës) është 'paksa' i lartë.

Shoqata e turizmit PRO IN ka 2.500 anëtarë individualë

11.2. Qasja strategjike

Në kuptim të politikave qendrore dhe lokale, turizmi ende nuk gëzon vëmendjen e merituar nga institucionet relevante, posaçërisht duke pasur parasysh synimin e sipërpërmendur të MTI-së që kjo industri të përbëjë 10-12% të BPV-së deri më 2020. Sfida më e madhe për zhvillimin e turizmit, sipas ekspertëve në sektor, është se turizmi po lihet jashtë fushave prioritare të agjendës së zhvillimit të përgjithshëm në Kosovë.³³ Prandaj, Kosova duhet të ketë strategji koherente për zhvillim të turizmit,

30 Gazeta Zyrtare e Kosovës, Ligji për turizmin, 10 maj 2013, at http://mti-ks.org/repository/docs/LAW_No_04-L-176_ON_TOURISM_Anglisht_772395.pdf

31 Po aty

32 Intervistë zyrtar të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, kryer më 25 nëntor 2013.

33 Intervistë me Zeke Çeku, ekspert i turizmit, intervistuar më 21 nëntor 2013.

e cila do të lejojë menaxhimin e resurseve paralele dhe zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit. Megjithatë, kjo nënkupton që, krahas qeverisë, pjesëmarrja e banorëve lokalë, si ndërmjetës mes sektorit privat dhe qeverisë, është thelbësore për mbrojtjen e resurseve natyrore dhe mjedisit në përgjithësi.³⁴

Për më tepër, institucionet përkatëse qeveritare duhet t'i zgjerojnë përpjekjet e tyre për t'i identifikuar sistematikisht fushat me potencial turistik dhe për të përcaktuar fuqitë dhe dobësitë e tyre. Ky proces do të shtronte rrugën për krijimin e një plani strategjik për turizëm, identifikimin dhe nënvizimin e destinacioneve specifike turistike, përcaktimin e strategjisë së marketingut për promovimin e turizmit dhe vendosjen e parimeve të masterplanit për zhvillim të turizmit në rajonet dhe territoret e Kosovës në tërësi. Strategjia sektoriale ende nuk është aprovuar, ndonëse është hartuar një draft nga MTI.³⁵ Kjo strategji është parakusht për zhvillim dhe ky dokument duhet t'i nënvizojë rajonet me potencialin më të madh për zhvillim, siç janë Prizreni, Peja, Prishtina dhe Gjakova.

"Kosova ka traditë në turizëm, që duhet të njihet që buron që nga vitet e 80-ta dhe për shkak të trazirave politike njëzetvjeçare në Kosovë dhe më gjerë ajo ka ngecur dhe nuk ka mundur t'i ndjekë hapat botërorë në industrinë e turizmit. Rezulton që ekzistenca e produktit turistik të Kosovës nuk mund të shpërfilllet, por është e domosdoshme të rishikohen resurset e regjistruara dhe të kategorizuara dhe me ndihmën e marketingut dhe instrumenteve të tij të përgatitet një plan dhe një strategji për performancën më të mirë sektoriale të ofertës në dispozicion në tregun vendor dhe ndërkombëtar të turizmit."³⁶ Deri më tani, janë realizuar një numër nismash të zhvillimit të turizmit edhe në nivel qendror edhe në atë lokal, kryesisht përmes asistencës së donatorëve (GIZ, SIDA, Care International, USAID KPEP), si dhe nga sektori publik dhe privat i Kosovës. Përderisa këto nisma individuale duket se kanë pasur sukses në një shkallë të vogël, ndikimi i tyre i mundshëm në zhvillimin e qëndrueshëm duket të jetë penguar kryesisht nga fokusi i tyre i ngushtë në zhvillimin ekonomik dhe mbrojtjen e mjedisit.

Ato nuk kanë rritur numrin e përgjithshëm të turistëve dhe, në veçanti, kanë synuar destinacione të caktuara lokale, meqë mungonte qasja kolektive e këtyre nismave për ta promovuar veten si produkt të përbashkët. Kjo është e domosdoshme nëse këta aktorë dëshirojnë ta bëjnë Kosovën konkurruese në tregun e turizmit global.³⁷

Në përgjithësi, projektet e organizatave ndërkombëtare dhe organizatave të shoqërisë civile deri në një masë kanë mbushur zbrazëtirat që i ka lënë qeveria, për të menaxhuar përgjegjshëm me këtë sektor. Megjithatë, shumica e projekteve janë mbështetur në modele të importuara dhe kishin mungesë të kontekstualizimit të duhur sipas kushteve dhe kapaciteteve lokale.³⁸

34 Valdete Rexhepi, Turizmi dhe Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçari: Rasti studimor i Kosovës, 2012, at www.ua.pt/event%5C-invtur2010/ReadObject.aspx?obj=23885

35 Intervistë zyrtar të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, kryer më 19 nëntor 2013

36 Fatos Ukaj, Koncepti i Marketingut si Mjet për Zhvillimin e Turizmit në Kosovë, 2010 http://mpira.ub.uni-muenchen.de/21720/1/MPRA_paper_21720.pdf

37 Strategjia për promovimin e investimeve e Agjencisë për Promovimin e Investimeve në Kosovë 2011-2013 http://www.invest-ks.org/repository/docs/02_Investment_Promotion_Strategy_656355.pdf

38 Intervistë me Zekë Çeku, ekspert i turizmit, intervistuar më 21 nëntor 2013

12. Kultura dhe turizmi: potencial në rritje

Ndikimi ekonomik i Dokufest gjatë katër viteve të ardhshme: €21.9 milionë

“Një zgjidhje e duhur dhe e qëndrueshme mbështetet në zhvillimin dhe promovimin e turizmit vendor, bazuar në burimet lokale, me njerëz lokalë të përfshirë në procesin e vendimarrjes dhe që përfitojnë direkt nga rezultatet/fitimet. Në mënyrë ideale, kjo realizohet me idenë e të menduarit globalisht dhe të vepruarit lokalisht, meqë traditat lokale dhe identiteti kulturor janë thelbësore për komunitetet në Kosovë.”³⁹

12.1. Festivalet dhe ngjarjet kulturore

Një numër ngjarjesh kulturore janë organizuar në qytete të ndryshme në Kosovë. Këto aktivitete kryesisht janë organizuar nga organizata të shoqërisë civile dhe operatorë kulturorë dhe tërheqin turistë vendorë dhe të huaj.

Një nga ngjarjet më me ndikim të organizuara çdo vit është festivali i filmit dokumentar **Dokufest** në Prizren. Sipas statistikave të festivalit, rreth 10,000 vetë kanë marrë pjesë në edicionin e viti 2013 të festivalit, ku 23% nga gjithsej numri i mysafirëve ishin vizitorë të huaj.⁴⁰ Hulumtimi i kryer nga Instituti GAP gjatë edicionit të dhjetë të këtij festivali (2011) tregon që ndikimi ekonomik i Dokufestit në BPV-në ishte €3.1 milionë, gjersa ky numër pritet të jetë €21.9 milionë gjatë periudhës së ardhshme katërvjeçare.⁴¹ Përfitues të drejtpërdrejtë të këtij festivali në qytet ishin bizneset, si baret, hotelet, restorantet, si dhe agjencitë turistike, bankat dhe kompanitë e telekomunikimit.

Ngjarje të ngjashme kulturore organizohen edhe në qytetet tjera të Kosovës. Ato përfshijnë Green Fest në Mitrovicë, Festivali ‘Into the Park’ në Pejë, Tour de Kosovo në qytete të ndryshme, Anibar në Pejë, NGOM Fest në Prizren, Skena UP në Prishtinë e kështu me radhë.

Green Fest, festival muzikor, është ngjarje atraktive për audiencat e Ballkanit, veçanërisht për të rinjtë. Meqë organizohet në Mitrovicë, ai ofron një element të veçantë atraktiv për audiencën ndërkombëtare, duke pasur parasysh specifikat politike të qytetit. Është një nga aktivitetet e rralla kulturore që i ofrohen vizitorëve të huaj në veri të Kosovës, por është dëshmuar të jetë festival i suksesshëm.⁴² Into the Park është festival që synon promovimin e artit, natyrës dhe turizmit në rajonin e Pejës. Prandaj, organizatorët e kanë caktuar datën e festivalit çdo vit gjatë stinës së verës ndërsa parku

NGOM Fest kishte 6,000 vizitorë në edicionin e vitit 2013

39 Këshilli i Evropës, Dilemë: përdorimi i trashëgimisë kulturore për turizëm apo shfrytëzimi i turizmit për mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e trashëgimisë kulturore?

40 Intervistë me Eroll Bilibanin, Drejtor ekzekutiv i Dokufest, intervistuar më 15 nëntor 2013

41 Instituti GAP, Ndikimi ekonomik i Dokufest, 2011 http://www.institutigap.org/documents/22462_TheEconomicImpactofDokuFest.pdf

42 Intervistë me Lulzim Hotin, Drejtor ekzekutiv i 7 Arte, intervistuar më 29 tetor 2013

përdoret si fushë për performancë. Përveç kësaj, ata ofrojnë turne me biçikleta dhe aktivitete të tjera për vizitorët në bashkëpunim me operatorët turistikë në rajon.⁴³

Tour de Kosovo është një tjetër atraksion turistik që shfrytëzon çiklizmin për të promovuar trashëgiminë kulturore dhe natyrore të Kosovës. Numri i pjesëmarrësve lokalë dhe të huaj në këtë ngjarje vazhdimisht po rritet (100 më 2008 dhe mbi 900 më 2013).⁴⁴ Në anën tjetër, Anibar (festival i filmit të animuar) më 2013 mbajti edicionin e katërt, duke pritur mbi 4,000 vizitorë. Numri i aplikimeve është rritur për 200% dhe shumica e tyre vinin nga producentë të huaj.⁴⁵ Anibar gjithashtu ofron programe të turneve speciale në lokacione të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në rajonin e Pejës.

Festivali NGOM është festival muzikor me bazë në Prizren, që çdo vit mbledh dhjetëra grupe muzikore dhe DJ nga e tërë bota. Ai tërheq mijëra vizitorë nga Kosova, rajoni dhe më gjerë (raportohet se edicioni 2013 priti mbi 6,000 vizitorë) dhe gjithashtu është shpërblyer nga qeveria lokale si ngjarja kulturore më masovike e vitit.⁴⁶ Për më tepër, Prishtina është gjithashtu nikoqire e ngjarjeve të shumta kulturore gjatë vitit. Një nga ngjarjet më të suksesshme në kuptim të tërheqjes së turistëve është festivali i filmit dhe teatrit Skena UP, i cili gjatë 11 viteve të organizimit të suksesshëm ka arritur të sjellë mijëra turistë nga e tërë bota në Prishtinë.⁴⁷

Një nismë e suksesshme e turizmit kulturor që duhet nënvizuar është realizuar në Prizren gjatë vitit 2013. Rrjeti i Organizatave Kulturore të Prizrenit (rrjet i mbi 25 OSHC-ve lokale kulturore) ka prodhuar Kalendarin Kulturor të qytetit.⁴⁸ Kalandari përfshin të gjitha ngjarjet kulturore, natyrore, rinore dhe të tjera turistike që organizohen gjatë tërë vitit në komunë. Kalandari është shpërndarë përmes kanaleve të ndryshme konvencionale dhe mediat sociale dhe paraqet një përpjekje konkrete për strukturimin e ofertës kulturore dhe turistike të qytetit.

Pjesëmarrësit në Tour de Kosovo: 100 më 2008 dhe mbi 900 më 2013

43 Intervistë me Gent Goranin, Into the Park, kryer më 30 tetor 2013

44 Intervistë me Enes Toskën, Menaxher Programi i organizatës Trashëgimia Kulturore pa Kufij, intervistuar më 1 nëntor 2013

45 Intervistë me Vullnet Sanajën, Udhëheqës i Festivalit Anibar, intervistuar më 6 nëntor 2013

46 Intervistë me Ardian Kazazin, Drejtor ekzekutiv i NGOM, intervistuar më 29 tetor 2013

47 Intervistë me Hana Qena, staf i Skena UP, intervistuar më 04 nëntor 2013

48 Rrjeti i Organizatave Kulturore në Prizren (RrOK Prizren), Kalandari Kulturor 2013, <http://rrok-pz.net/kalandari/>

13. Mungesa e mbështetjes institucionale

Niveli i bashkëpunimit mes pushtetit lokal dhe atij qendror ndryshon nga rasti në rast. Aty ku qeveritë lokale kanë departamente të turizmit, shumë organizatorë të ngjarjeve kulturore iu qasjen atyre për të kërkuar mbështetje financiare. Kjo qasje kufizon efektet e këtyre ngjarjeve, meqë ato nuk janë të planifikuara, të mbështetura dhe ekzekutuara si pjesë e një promovimi dhe strategjie zhvillimore më të gjerë të turizmit. Një aspekt tjetër shqetësues është mbështetja shumë modeste financiare që vjen nga qeveritë lokale. Green Fest në Mitrovicë ka marrë financim të kufizuar, ndërsa Tour de Kosovo nuk ka pranuar asnjë mbështetje financiare nga komunat në të cilat zhvillohet ky turne. Qeveria lokale e Prizrenit kontribuon me vetëm 5% të buxhetit të përgjithshëm në Dokufest, dhe zakonisht paratë transferohen me disa muaj vonesë.

Lista e pengesave në promovimin e turizmit kulturor në Kosovë është e gjatë dhe organizatorët kanë listuar vështirësitë në vijim në veprimtarinë e tyre:

- Financim i kufizuar nga qeveria qendrore dhe lokale,
- Mungesa e politikave të duhura kulturore dhe të turizmit në nivel lokal të qeverisë,
- Pamundësia e qeverive lokale që ta integrojnë kulturën në një kornizë më të gjerë strategjike të zhvillimit të turizmit,
- Infrastruktura joadekuate fizike për ngjarjet kulturore dhe artistike, dhe
- Bashkëpunim i pamjaftueshëm ndërmjet ngjarjeve kulturore dhe operatorëve të tjerë turistikë (kryesisht biznese private).

14. Asistenca ndërkombëtare për zhvillim të turizmit

Në Kosovë janë realizuar një numër projektsh zhvillimore nga organizata dhe institucione të ndryshme, të cilat kryesisht kanë pranuar financim ndërkombëtar. Agjencitë më të rëndomta donatore për projekte të zhvillimit të turizmit ishin Bashkimi Evropian, Agjencia Gjermane për Zhvillim Ndërkombëtar GIZ, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar dhe disa agjenci të tjera kombëtare.

Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë i ka dhënë prioritet të lartë mbështetjes për Zhvillimin Ekonomik Rajonal (ZHER) në Kosovë në pajtim me praktikën më të mira evropiane, ku turizmi gëzonte vëmendje qendrore në strategjitë për zhvillimin rajonal. Puna drejt zhvillimit ekonomik rajonal filloi më 2008 me nisjen e përgatitjeve për projektin e parë të asistencës teknike për themelimin e një rrjeti të AZHR-ve për ta mbuluar territorin e Kosovës. Aktualisht, pesë Agjencitë e Zhvillimit Rajonal zbatojnë një agjendë dinamike të zhvillimit dhe në tre vitet e fundit kanë nisur një numër projektsh të zhvillimit të turizmit.⁴⁹

Si një nga praktikën e mira, Komisioni Evropian financoi Projektin e Zhvillimit të Turizmit “Shihemi në Dukagjin”, të zbatuar nga organizata Trashëgimia Kulturore pa Kufij. Qëllimi i projektit është që të kontribuojë në krijimin e bazës për zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë dhe në konsolidimin e rajoneve ekonomike, krijimin e një kuadri të zhvillimit rajonal dhe mbështetjen e rigjenerimit ekonomik, krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në rajonet ekonomike.⁵⁰

GIZ ka mbështetur rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit privat dhe projektet e zhvillimit ekonomik rural. Këto projekte trajtonin këto fusha të intervenimit: Mbështetje për zhvillim të produkteve, kualifikim, dhe rrjeteve rajonale, Ndihmë me zbatimin e strategjisë së turizmit të Kosovës, Promovimi i planifikimit dhe zbatimit të projekteve strategjike në zhvillimin e turizmit rajonal në jug dhe në lindje të Kosovës, Analiza e potencialit transnacional të turizmit në jug të rajonit të Sharrit si pjesë e studimit për bashkëpunim ndërkombëtar, Promovimi i zhvillimit të turizmit të bazuar në komunitet në Shtërpce me fokus në forcimin e produkteve turistike gjatë gjithë vitit dhe integrimin rajonal, dhe Promovimi i turizmit të banjave në rajonin e Klllokotit.⁵¹

UNDP Kosovë mbështetë zhvillimin e turizmit në Kosovë përmes projektit Menaxhimi i Qëndrueshëm i Shfrytëzimit të Tokës dhe Konservimi i Biodiversitetit në komunën e Dragashit. Përveç kësaj, projekti Ndihmë për Tregti synon të përmirësojë zbatimin e reformave në favor të tregtisë së të varfërve dhe masat e zhvillimit të kapaciteteve të tregtisë, me fokus në mungesat në kapacitete, dhe asistenca teknike

49 Për më shumë informata lidhur me punën e AZHR vizitoni: www.rdawest.org, www.rdacentre.org, www.rdaeast.org, www.rdanorth.org, www.rda-south.org

50 Trashëgimia Kulturore pa Kufij, CHwB Kosova pranon mbështetje për projekte të turizmit kulturor <http://www.chwb.org/index.php?newsId=231>

51 Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), Projektet e turizmit të bashkëpunimit për zhvillim <http://www.giz.de/expertise/downloads/en-tourism-projects.pdf>

për Mistrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Në nivel lokal projekti synon të rritë produktivitetin, punësimin dhe ndërmarrësinë, me fokus në rajonin ekonomik jugor dhe duke punuar me ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.⁵² Projekti i parë me fokus në Dragash synon të përmirësojë jetesën e njerëzve lokalë përmes mbrojtje së burimeve natyrore; promovimit të burimeve vendore; përmirësimit të kapaciteteve të fermerëve dhe prodhuesve; përmirësimit të efikasitetit të energjisë; dhe qeverisjes së mirë dhe barazisë më të mirë gjinore.⁵³

Programi i Ndërmarrjeve Private të Kosovës (KPEP) ishte një aktivitet katërvjeçar i krijuar për të stimuluar ekonominë e Kosovës duke rritur konkurrueshmërinë e bizneseve private, me mbështetje të USAID-it. Programi KPEP, i mbështetur nga USAID, u lansua në fund të vitit 2008. Turizmi është lansuar si aktivitet kyç për KPEP në fillim të vitit 2009.

52 UNDP Kosovë, projekti Ndhinë për Tregti http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/operations/projects/poverty_reduction/AFT.html

53 UNDP Kosovë, Projekti Menaxhimi i Qëndrueshëm i Përdorimit të Tokës dhe Mbrojtja e Biodiversitetit në Komunën e Dragashit, http://www.ks.undp.org/content/kosovo/en/home/operations/projects/environment_and_energy/sustainable-land-use-management-and-conservation-of-biodiversity.html

15. Konkluzë dhe rekomandime

Sfida e parë për zhvillimin e sektorit të turizmit është mungesa e të dhënave dhe statistikave zyrtare. Prandaj, të dhënat janë nxjerrë nga një varg burimesh për ta fituar një pasqyrë të përgjithshme të kësaj industrie. Kjo ndodhë, pjesërisht, nga mungesa e një kuptimi të përbashkët të asaj se si lidhen agjencitë e ndryshme qeveritare me turizmin. MTI ka paraqitur një listë të bizneseve që konsiderohen si subjekte të turizmit, por duke pasur parasysh ndikimin ekonomik të aktiviteteve kulturore (festivaleve dhe ngjarjeve të ngjashme), duhet të bëhet një ripërkufizim për ta ngritur dhe zgjeruar këtë listë të subjekteve që konsiderohen se lidhen me turizëm.

Përveç kësaj, ekziston një konsensus tek ekspertët e sektorit dhe politikëbërësit që përderisa turizmi nuk konsiderohet si fushë prioritare, zhvillimi i sektorit dhe ndikimi i tij në rritjen ekonomike të Kosovës do të vazhdojë të jetë i kufizuar. Turizmi qeveriset nga një ligj i nivelit qendror, por të cilit i mungon strategjia për zhvillim. Në të njëjtën kohë, përgjegjësia për sektorin është vënë nën Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, dhe menaxhohet nga vetëm tre zyrtarë të cilët edhe përbëjnë Divizionin e Turizmit.

Turizmi ka pranuar financim të kufizuar qeveritar, meqë nuk është politikë prioritare. Me burime të kufizuara financiare, Qeveria nuk mund ta përballojë asnjë vlerësim të duhur të potencialit të turizmit, lëre më të kryej studime të fizibilitetit dhe hartime të planeve strategjike. Megjithatë, kjo mangësi është trajtuar me financim ndërkombëtar të siguruar nga donatorë të ndryshëm që kanë mbështetur një varg projektsh të zhvillimit të turizmit.

Kosova ka mungesë të menaxherëve të turizmit dhe profesionistëve të nivelit të mesëm të hoteleve dhe restoranteve. Menaxherët që drejtojnë biznese të turizmit kanë mungesë të arsimit të duhur formal, gjersa stafi i nivelit të mesëm zakonisht përbën të rinj të pakualifikuar që nuk kanë mundësi të aftësisimit dhe trajnimit. Numri i ulët i pronareve gra në biznese i shtohet problemit të menaxherëve të arsimuar, duke pasur parasysh se përqindja aktuale (9.1%) është mospërputhje e madhe me përqindjen e popullatës së grave.

Disa shkolla të mesme në Kosovë kanë lëndë për turizëm dhe menaxhim/shërbime hotelerie, gjersa tri institucione të shkollimit të lartë në Kosovë (dy kolegje private dhe një universitet publik) ofrojnë studime për turizëm. Plan-programi i kate-drave të universiteteve ka nevojë të përmirësohet më shumë në mënyrë që të jetë më konkurrent dhe në hap me zhvillimet moderne ndërkombëtare në këtë sektor.

Në përgjithësi, Kosova dhe shumica e qyteteve të tij kanë mungesë të materialeve të duhura për promovimin e turizmit. Mosaprovimi i strategjisë së zhvillimit të turizmit ka ngadalësuar bashkërendimin institucional dhe ka pasur ndikim në nismat për promovimin e turizmit, gjersa shumë qytete kanë mungesë të pikave adekuata për informim të turistëve.



Është e qartë se këto sfida nuk janë të natyrës komplekse. Vendorsja e turizmit më lartë në listën e prioriteteve në strategjinë zhvillimore të Kosovës dhe politikat publike medoemos do të ketë ndikim pozitiv për tejkalimin e shumë sfidave të identifikuara në këtë raport. Qeveria e Kosovës duhet ta konsiderojë turizmin si potencial të vërtetë për zhvillim dhe t'i ftojë të gjithë aktorët relevantë (komunat, bizneset, shoqërinë civile, operatorët turistikë, etj.) për një dialog përfshirës të politikave që do të mund të prodhonte një qasje strategjike për zhvillimin e turizmit. Roli i Këshillit të sapoformuar për Turizëm në Kosovë është thelbësor në bashkërendimin e procesit të dialogut të politikave.

Referencat

Legjislacioni

- *Gazeta Zyrtare e Kosovës, Ligji për taksën e akomodimit në objekte hoteliere e turistike, 7 janar 2009*
- *Gazeta Zyrtare e Kosovës, Ligji për turizmin, 10 maj 2013*
- *Republika e Kosovës, Gazeta Zyrtare, Ligji për patentat*

Raportet, dokumentet dhe statistikat

- *Këshilli i Evropës, Dilemë: përdorimi i trashëgimisë kulturore për turizëm apo shfrytëzimi i turizmit për mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e trashëgimisë kulturore?*
- *Fatos Ukaj, Koncepti i Marketingut si Mjet për Zhvillimin e Turizmit në Kosovë, 2010*
- *Instituti GAP, Ndikimi ekonomik i Dokufestit, 2011*
- *Strategjia për promovimin e investimeve e Agjencisë për Promovimin e Investimeve në Kosovë 2011-2013*
- *IPVQ, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Raporti i zhvillimit hapësinor për sektorin e turizmit, 2004*
- *Republika e Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Bruto Prodhimi Vendor sipas veprimtarive ekonomike (2006 – 2011), 2012*
- *Republika e Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistika të hotelierisë, 2013*
- *Republika e Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Investo në Kosovë, 2011*
- *Valdete Rexhepi, Turizmi dhe Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit: Rasti studimor i Kosovës, 2012*

Intervistat

- *Afrim Fushtica dhe Xhevdet Hyseni, udhëheqës të shoqatës PRO IN, intervistuar më 21 nëntor 2013*
- *Arben Islami, Hiking Njeri, intervistuar më 1 dhjetor 2013*
- *Ardian Kazazi, Drejtor Ekzekutiv i N'GO, intervistuar më 29 tetor 2013*
- *Bajram Basha, udhëheqës i Shoqatës së Turizmit, rajoni jugor, intervistuar më 27 nëntor 2013*
- *Baki Hoti, udhëheqës i Shoqatës së Turizmit Alternativ të Kosovës, intervistuar më 19 nëntor 2013*
- *Enes Toska, Menaxher Programi i organizatës Trashëgimia Kulturore pa Kufij, intervistuar më 1 nëntor 2013*
- *Eroll Bilibani, Drejtor Ekzekutiv i Dokufest, intervistuar më 15 nëntor 2013*
- *Gent Gorani, stafi i Into the Park, intervistuar më 30 tetor 2013*
- *Hana Qena, Skena UP, intervistuar më 04 nëntor 2013*
- *Lulzim Hoti, Drejtor Ekzekutiv i 7 Arte, intervistuar më 29 tetor 2013*
- *Zyrtarë të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, intervistuar më 19 dhe 25 nëntor*

- *Shkelqim Jupa, pronar i Çarshia e Jupave, intervistuar më 26 nëntor 2013*
- *Veli Bakija, Komuna e Gjakovës, intervistuar më 26 nëntor 2013*
- *Virtyt Morina, Komuna e Pejës, intervistuar më 25 nëntor 2013*
- *Vullnet Sanaja, Udhëheqës i Festivalit Anibar, intervistuar më 6 nëntor 2013*
- *Zekë Çeku, Ekspert i Turizmit, intervistuar më 21 nëntor 2013*

Të tjera

- *Marrëveshja për tregti të lirë në Evropën Qendrore*
- *Agjencia për Promovimin e Investimeve në Kosovë*
- *Shoqata e Turizmit Alternativ në Kosovë (SHATK)*
- *Shoqata e Turizmit në Kosovë (KOTAS)*
- *Komuna e Prizrenit, Drejtoritë*
- *Përfaqësues i Tregtisë së SHBA-së, produktet e pranueshme në GSP*
- *Trashëgimia Kulturore pa Kufij, CHwB*
- *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ)*
- *Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, Kosovë*



